

20110471315

## L I G J

### **PËR GARANCI TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE NDAJ DETYRIMEVE SIPAS MARREVESHJES PËR HUA PËR FINANCIM PLOTESUES TË PROJEKTIT PËR SHA MEPSO, QË DO TË LIDHET NDERMJET BANKES NDERKOMBETARE PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM - BANKA BOTERORE DHE SHA MEPSO**

#### Neni 1

Republika e Maqedonise e garanton permbushjen e detyrimeve dhe plotesimin e dispozitave të Marreveshjes për hua të dedikuar për financim plotesues të Projektit për SHA MEPSO që do të lidhet ndermjet Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Bankes Boterore dhe SHA MEPSO në shume prej 14 000 000 eurosh, në afate dhe kushte të parapara në Marreveshje për hua, nese SHA MEPSO nuk i permbush dhe servison detyrimet nga Marreveshja për hua.

#### Neni 2

Kushtet dhe menyren e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji percaktohen me Marreveshje për hua, që do të lidhet ndermjet Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Bankes Boterore dhe SHA MEPSO për financim plotesues të Projektit për SHA MEPSO.

#### Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marreveshja për hua nga neni 1 i ketij ligji, si dhe servisimin e huas do ta kryeje SHA MEPSO nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të percaktuara në Marreveshje për hua.

#### Neni 4

Afati i pageses së huas nga neni 1 i ketij ligji eshte 22 vite, me grejs periodhe të perfshire prej gjashte vitesh.

Shkalla e kamates eshte EURIBOR gjashtemujor me shtrirje variabile.

Në ditën e terheqjes së mjeteve të huas, Republika e Maqedonise do t'i paguaje Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Bankes Boterore provizion të njehershem në shume prej 0,25 % nga shuma e huas.

Huaja do të paguhet në 32 keste gjysmevjete, në çdo 15 maj dhe 15 nentor të vitit. Nga 15 maji 2017 deri më 15 maj 2032 do të paguhen 31 keste gjysmevjete secila në shume prej 3,13 % nga shuma e huas, ndersa më 15 nentor 2032 do të paguhet kesti i fundit në shume prej 2,97% nga shuma e huas.

#### Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella që dalin nga Marreveshja për hua dhe Marreveshja për garanci, Ministria e Financave dhe SHA MEPSO do të lidhin marreveshje të vecante.

#### Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".